



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

*lidhur me vizitën në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës –
Urgjenca dhe Kujdesi Intensiv Psikiatrik*

Për: **Z. Arben Vitia, ministër**
Ministria e Shëndetësisë

Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë

Z. Elvir Azizi, drejtor
Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

Kopje: **Z. Habit Hajredini, drejtor**
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Faton Kutllovci, drejtor
Klinika Psikiatrike

Prishtinë, 3 tetor 2023

Qëllimi i vizitës

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm: MKP) i Avokatit të Popullit, më 3 mars 2023 ka vizituar Repartin e Urgjencës dhe të Kujdesit Intensiv Psikiatrik (në tekstin e mëtejshëm: UKIP).

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të personave me probleme mendore, të hospitalizuar në repartin e mbyllur të Klinikës Psikiatrike, për trajtim të pavullnetshëm, të cilët policia apo familjarët i kanë sjellë për trajtim.

Bashkëpunimi i institucionit me MKP-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës, personeli i Klinikës Psikiatrike i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues. Ekipi pa vonesa pati qasje në hapësirat e Klinikës Psikiatrike dhe në Repartin e UKIP-it dhe iu mundësuan bisedat me pacientët, pa prezencë të personelit mjekësor.

Legjislacioni relevant

1. Deklarata Universale për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, e miratuar nga OKB-ja, më 10 dhjetor 1948, Neni 1, përcakton: *“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.”*
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në Nenin 23, përcakton: *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”*
3. Po me Kushtetutë, në Nenin 27, është përcaktuar: *“Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.”*
4. Mbi këto parime, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në dispozitën e Nenit 51, paragrafi 1, ka përcaktuar: *“Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.”*
5. Ligji për Shëndetin Mendor, Neni 2, përcakton: *“Me këtë ligj përcaktohen procedurat, kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, mjedisit social të përshtatshëm për personat me çrregullime mendore dhe politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.”*
6. Neni 6 i Ligjit përcakton: *“Të drejtat e personave me çrregullime mendore”, duke listuar të drejtat që gëzojnë:*

Personat me çrregullime mendore gëzojnë:

- të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë;
- të drejtën të marrin shërbim shëndetësor të arritshëm dhe efikas në kushte të barabarta si të gjithë pacientët e tjerë;
- të drejtën për trajtim dhe mbrojtje, bazuar në respekt të individualitetit dhe dinjitetit të tyre;
- të drejtën për të pranuar ose jo ndërhyrjen e propozuar diagnostike e terapeutike, përveç rasteve të tjera të parashikuara në këtë ligj;
- të drejtën për t'u informuar për të drejtat e tyre, si dhe për të qenë pjesë e hartimit të planit individual të trajtimit;

- të drejtën për kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga gabimi në trajtim ose keqtrajtimet e mundshme;
 - të drejtën për të kërkuar rishqyrtimin e shtrimit apo mjekimit të detyruar;
 - të drejtën për konfidencialitet mbi të dhënat për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore;
 - të drejtën për të mos u detyruar forcërisht të ekzaminohen nga pikëpamja mjekësore me qëllim përcaktimin e një çrregullimi mendor të mundshëm, me përjashtim të rasteve sipas procedurave të parapara në këtë ligj;
 - të drejtën për t`u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë;
 - të drejtën për t`u ankuar për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor.
7. Më tej Ligji, me dispozitën e Nenit 8 - Mbrojtja nga diskriminimi dhe trajtimet çnjerëzore - ka përcaktuar:
- “Personave me çrregullime mendore u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe dispozitave ligjore në fuqi. Ndalohet çfarëdo shkelje, nënçmimi, torture, dënimi apo trajtimi çnjerëzor ndaj personit me çrregullime mendore.”*
8. Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Shëndetin Mendor i Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 të Statutit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ShSKUK), Klinika Psikiatrike është njësi organizative e ShSKUK-së. Sipas ligjit në fuqi, Klinika Psikiatrike ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë), por është e detyruar të ofrojë edhe shërbime të nivelit sekondar për regjionin e Prishtinës, në mungesë të një spitali të përgjithshëm regional. Të gjitha repartet (përveç Repartit të UKIP-it) janë të hapura dhe bëjnë trajtimin me vullnetin e pacientëve dhe në raste të caktuara edhe pa vullnetin e tyre, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.
9. Dispozitat ligjore përkatëse për vendosjen e pavullnetshme, të natyrës civile, rregullohen me Ligjin për Shëndetin Mendor (LShM)¹ (nenet 20-24), i cili ishte miratuar në vitin 2015, dhe me Ligjin për Procedurën Jokontestimore² (nenet 75 deri në 96).
10. Neni 75, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën Jokontestimore (Vendosja dhe mbajtja e të sëmurit psikik në institucionin shëndetësor) përcakton: *“Sipas rregullave të kësaj procedure gjykata me aktvendim vendosë për mbajtjen e personit të sëmurë mendërisht (psikik) në institucionin shëndetësor, kur për shkak të natyrës së sëmundjes është e domosdoshme që personi i këtillë të kufizohet në lirinë e lëvizjes dhe të komunikimit me njerëzit jashtë institucionit në fjalë.”*
11. Ndërsa neni 75, paragrafi 2, përcakton: *“Sipas rregullave të kësaj procedure gjykata vendosë edhe për lirimin e të sëmurit psikik nga institucioni shëndetësor kur pushojnë shkaqet për të cilat ai është vendosur apo ndaluar në institucionin e këtillë.”*

¹ Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor.

² Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

12. Neni 20, paragrafi 1, i Ligjit për Shëndetin Mendor thekson: *“Subjekt i trajtimit të pavullnetshëm është personi, i cili shtrohet në mënyrë të pavullnetshme në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër ose pasi është shtruar në mënyrë të vullnetshme mbahet në mënyrë të pavullnetshme, sipas përcaktimit të Komisionit të mjekëve specialist.”*
13. MKP-ja vëren se nenet 22-23 të Ligjit për Shëndetin Mendor e rregullojnë çështjen e pranimit të pavullnetshëm të pacientëve pa vendim të gjykatës kompetente. Neni 22, paragrafi 4, përcakton: *“Mjeku në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, që vendos për trajtimin e pavullnetshëm, përshkruan në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore të gjitha procedurat e ndjekura dhe siguron njoftimin e shefit të shërbimit për shtrimin e pavullnetshëm, brenda njëzet e katër (24) orëve.”*
14. Megjithatë, MKP0ja vëren se neni 23, paragrafi 4, i Ligjit të Shëndetit Mendor përcakton: *“Në rast pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se ekzistojnë shkaqet që personi të mbahet në kushte trajtimi të pavullnetshëm, personi vazhdon të marrë trajtimin e pavullnetshëm në këtë shërbim. Pas këtij vendimi, brenda dyzet e tetë (48) orëve, udhëheqësi i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës themelore për të vlerësuar procedurën e kryer. Një kopje e kërkesës i vihet në dispozicion pacientit, një familjari të afërt dhe/ose përfaqësuesit ligjor të tij.”*
15. MKP-ja vëren mospërputhje mes dispozitave ligjore të përfshira në Ligjin nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, ku neni 76 i këtij ligji përcakton: *“Institucioni shëndetësor mund ta pranojë për shërim personin e sëmurë mendërisht me pëlqimin e tij, në qoftë se natyra e sëmundjes së tij e lejon dhënien e pëlqimit të këtillë.”*
16. Kurse neni 77 i po këtij ligji përcakton: *“Në qoftë se personit nga paragrafi 1 i nenit 76 i është kufizuar liria e lëvizjes apo e kontaktimit me personat jashtë institucionit shëndetësor, atëherë institucioni shëndetësor ka për detyrë që brenda 24 orëve ta njoftojë gjykatën me shkrim për një gjë të tillë.”*
17. Më tej neni 78 i Ligjit për Procedurën Jokontestimore përcakton: *“Kur institucioni shëndetësor e pranon për shërim personin e sëmurë mendërisht pa pëlqimin e tij dhe pa vendim të gjykatës, ka për detyrë që për një gjë të këtillë ta njoftojë menjëherë me anë të një shkrese, e më së voni brenda 24 orëve, gjykatën në territorin e së cilës ndodhet ky institucion.”*
18. Neni 21, paragrafi 1.2, i Ligjit për Shëndetin Mendor thekson: *“Pacienti, i cili i nënshtrohet trajtimit të pavullnetshëm, ka të drejtë të përfaqësojë personalisht interesat e ligjshme gjatë veprimeve procedurale gjatë shtrimit të pavullnetshëm. Në situata ku gjendja shëndetësore nuk e lejon, këto interesa përfaqësohen nga përfaqësuesi ligjor; paragrafi 1.3 i po këtij neni thekson se pacienti gjithashtu ka të drejtë “t”i garantohet mbrojtja ligjore në të gjitha veprimet procedurale në të cilat ai merr pjesë, si dhe në ato veprime procedurale, që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me të dhe ku ai nuk është i pranishëm.”*

Klinika e Psikiatrisë

19. Klinika Psikiatrike përbëhet nga 6 reparte të ndara: Reparti A, ku trajtohen aktualisht të gjitha çrregullimet kronike psikotike; Reparti B, për trajtimin e çrregullimeve të depresionit, ankthit dhe çrregullimeve të personalitetit; Reparti i Sëmundjeve të Varësisë (RSV), ku trajtohen të gjitha rastet e varësisë nga alkooli, barnat e përkrahura, substancat narkotike (Kokaina, Heroin etj.); Reparti i mbyllur i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP), ku trajtohen rastet në mënyrë të pavullnetshme; Qendra e Shëndetit Mendor apo Psikiatria për Fëmijë dhe Adoleshentë, që funksionon si pjesë e Klinikës Psikiatrike, me objekt ndaras, ku ofrohen shërbime ambulatorë ditore për moshat nën 18 vjeç. Sipas njoftimit të drejtorit, tani Klinika e ka edhe Repartin A1 për çrregullimet akute psikotike, me kapacitet prej 6 shtretërish, ku hospitalizohen edhe fëmijët nën moshën 18 vjeç, për shkak të mungesës së shtretërve për fëmijë në shërbimin për fëmijë dhe adoleshentë.
20. Klinika Psikiatrike nuk ka repart për trajtimin e të moshuarve, të fëmijëve dhe të adoleshentëve. Në repartet e lartcekura trajtohen pacientët nga mosha 16-65 vjeç. Megjithatë, vendosja e të miturve dhe e të moshuarve është praktikë gati e përhershme dhe në njëfarë mënyre e detyruar, për shkak se për të miturit nuk ka shtretër tek Psikiatria për Fëmijë dhe Adoleshentë, po ashtu edhe të moshuarit nuk kanë hapësira të tjera hospitalizimi.
21. Sipas njoftimit të drejtorit të Klinikës së Psikiatrisë, përmes një projekti nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, shërbimi psikiatrik për fëmijë dhe adoleshentë pritet në të ardhmen të bëhet me shtretër.

Avokati i Popullit, përmes MKP-së, do t'i ndjekë veprimet e autoriteteve lidhur me këtë çështje.

22. Gjatë vizitës së realizuar në vitin 2018, MKP-ja ka vërejtur se në Repartin e Sëmundjeve të Varësisë (RSV) nuk ka dhoma të mjaftueshme për trajtimin e pacientëve (vetëm 6 shtretër). Kurse gjatë vizitës së fundit, realizuar në mars 2023, MKP-ja u njoftua nga drejtori i Klinikës se është vënë në funksion pjesa e re e Repartit të RSV-së, me kapacitet 11 shtretër. Në kuadër të këtij reparti, sipas protokollit klinik, ofrohet shërbimi i detoksikimit, që bëhet për 7 ditë, dhe ofrim i përkrahjes dhe i mbështetjes psikoterapeutike, e që trajtimi përfundon brenda 2 javësh. Në kuadër të këtij reparti ofrohet edhe shërbimi i mbajtjes me Metadon të pacientëve, në formë ambulatorë. Megjithatë, ky repart nuk është zgjidhje për personat e varur nga drogat, pasi pacientët qëndrojnë në këtë repart deri në 2 javë të hospitalizuar dhe pas përfundimit të detoksikimit, trajtimi vazhdon në rrethin familjar.

Personeli i Klinikës Psikiatrike

23. Personeli në gjithë Klinikën Psikiatrike përbëhet nga 25 psikiatër, 48 infermierë, 3 psikologë në Klinikën Psikiatrike dhe 3 psikologë, 1 pedagogë dhe 1 edukatore speciale në Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adoleshentëve. Drejtori thekson se përreth 7 vjet nuk kanë punëtor social dhe se mungesa e punëtorit social po shkakton vështirësi në punë, sidomos për rastet e trajtimit të pavullnetshëm në Repartin UKIP. MKP-ja, në Raportin me

rekomandime lidhur me vizitën në Klinikën Psikiatrike të ShSKUK-së³, e ka potencuar se punëtorja sociale është pensionuar dhe nuk është zëvendësuar asnjëherë.

24. Sigurimi në Repartin UKIP ofrohej nga sigurimi privat, të cilin e kryenin dy persona të cilët nuk kishin ndonjë përgatitje ose trajnim të përafërt me natyrën e punës në institucion psikiatrik. Edhe pse intervenimi në raste të incidenteve nuk është mandat i sigurimit, ata janë ftuar disa herë nga personeli mjekësor për të intervenuar. MKP-ja konsideron se është e rëndësishme qenësore që personeli i cili caktohet në detyra të ndërlidhura me sigurinë në një institucion psikiatrik, të përzgjidhet në mënyrë të kujdesshme dhe që t'u nënshtrohen trajnimeve adekuate para se t'i marrin përsipër detyrat e tyre. Po ashtu, ata gjatë kryerjes së detyrave duhet të mbikëqyren për së afërmi dhe t'i binden autoritetit të personelit të kualifikuar mjekësor.

Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik

25. Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP) është njësi e mbyllur dhe funksionon në kuadër të Klinikës Psikiatrike. Në këtë repart trajtohen rastet e çrregullimeve të ndryshme psikotike, të çrregullimeve bipolare dhe të çrregullimeve të personalitetit që nuk mund të trajtohen në repartet e tjera të hapura. Ky repart është i vetmi në tërë territorin e Kosovës. Në spitalet e tjera regjionale, repartet psikiatrike nuk i kanë funksionale dhomat e veçanta ku trajtohen rastet urgjente. Rastet e tilla nga tërë Kosova sillen në Repartin UKIP të Klinikës Psikiatrike në Prishtinë.

26. Avokati i Popullit, përmes raportit me rekomandime, në vitin 2018⁴ u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente aktivizimin e këtyre dhomave të veçanta për trajtimin e rasteve urgjente, mirëpo gjendja mbetet e njëjtë dhe ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Trajtimi fizik

27. Gjatë realizimit të vizitave ad-hoc dhe vizitave të përgjithshme, ekipi monitorues i MKP-së nuk ka vërejtur ndonjë rrethanë që mund të shprehë dyshimin për keqtrajtim apo nënçmim ndaj personave të vendosur në këtë repart. Po ashtu, MKP-ja nuk ka marrë asnjë ankesë nga pacientët për keqtrajtim fizik apo për sjellje të personelit, e cila do ta fyente dinjitetin e pacientit.

Masat mbrojtëse

28. Në Repartin UKIP, në përgjithësi, pacientët sillen nga familjarët ose nga policia dhe janë pacientë të cilët akomodohen pa vullnetin e tyre. Sipas drejtorit, pas pranimit të pacientit, brenda 24 orësh bëhet vlerësimi i gjendjes së tij/saj shëndetësore nga një komision mjekësor neutral prej tre anëtarësh (të cilët nuk janë staf i UKIP-it) dhe vlerësojnë pacientin a është për trajtim të pavullnetshëm në UKIP apo për reparte të hapura në Klinikën Psikiatrike.
29. Në Raportin për vizitën në Klinikën Psikiatrike, publikuar në tetor të vitit 2018⁵, Avokati i Popullit, përmes gjetjeve të MKP-së, kishte konstatuar se për pranimin e pacientit për

³ Shih Raportin për vizitën në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, i publikuar më 26 tetor 2018: <https://oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-klinikene-psikiatrike-ne-qkuk/>

⁴ MKPT, Raport me rekomandime për vizitën në Klinikën Psikiatrike në Prishtinë, publikuar më 26 tetor 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-klinikene-psikiatrike-ne-qkuk/>.

trajtim të pavullnetshëm, asnjëherë nuk është njoftuar gjykata kompetente. Për më shumë, ky moszbatim i ligjit ka vazhduar për vite me radhë dhe, përveç Avokatit të Popullit, këtë gjendje me shqetësim e kishte konstatuar edhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), në raportin për vizitën në Kosovë në vitet 2007, 2010, 2015 dhe së fundmi në raportin për vizitën në Kosovë, i publikuar në shtator 2021.⁶ Në të gjitha këto raporte, KPT-ja kishte shprehur shqetësimin serioz për shkak të moszbatimit të ligjit relevant në këtë pikë si dhe kishte konstatuar mospërputhje mes dispozitave ligjore të përfshira në Ligjin nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore (nenet 75 deri në 96) dhe dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor (nenet 20 deri 24).

30. Gjatë realizimit të vizitave në shtator 2022 dhe në mars 2023, MKP-ja është njoftuar se drejtori i Klinikës Psikiatrike ka bërë përpjekje për këtë çështje, ku i ka dërguar rreth 25 dosje të pacientëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për t'i njoftuar për trajtim të pavullnetshëm, mirëpo kjo gjë ende nuk është zgjidhur, pasi sipas pohimeve të drejtorit, Gjykata Themelore në Prishtinë po i vonon përgjigjet, edhe pse është e njoftuar se në Urgjencë Psikiatrike, pacienti nuk mund të qëndrojë më shumë se 3 javë dhe ka nevojë që sa më shpejt të trajtohet. Gjykata Themelore në Prishtinë ka kërkuar që procedimi i rasteve për trajtim të pavullnetshëm të bëhet në pajtim me ligjet në fuqi.

Kushtet e akomodimit në Repartin UKIP

31. Kapaciteti i Repartit UKIP është 14 shtretër, të ndarë në dy krahë: 7 shtretër për meshkuj dhe 7 shtretër për femra. Reparti posedon edhe 4 dhoma të izolimit. Në ditën e vizitës në MKP, në këtë repart ishin të akomoduar katër pacientë.
32. MKP-ja ka vërejtur se muret në këtë repart ka kohë që nuk janë gëlqerosur, disa xhama të dritareve janë të krisur, po ashtu dritaret kanë grila hekuri. Banjat kanë lagështi, banja e femrave është jashtë funksionit, për shkak të rrjedhjes së ujit.
33. Gjithashtu, edhe në kuzhinën e repartit ka lagështi dhe në korridore pikon uji gjatë kohës me shi. Dhomat janë me nga dy shtretër, me hapësirë të përshtatshme, me dritë dhe ajrosje dhe janë të ngrohta. Hapësirat e dhomave nuk kanë stolisje, disa piktura janë në mure të dhomës së ditës dhe të ushqimit.
34. Dhomat e izolimit janë të demoluara dhe nuk kanë ventilim, njëra prej tyre është jashtë funksionit. Drejtori i Klinikës i ka rregulluar muret e dy dhomave të izolimit, mirëpo ekipi monitorues po ashtu ka vërejtur se dhomat e izolimit janë larg personelit shëndetësor dhe nëse pacientët kanë ndonjë nevojë, është e pamundur të dëgjohen nga personeli mjekësor, sepse butoni i alarmit është jashtë funksionit. Ekipi i MKP-së konstaton se dhomat e izolimit nuk i plotësojnë as kushtet minimale për qëndrim dhe kushtet në përgjithësi në UKIP nuk janë të mira.

⁵ Po aty.

⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2007, paragrafi 131, publikuar në vitin 2009. Shih në: <https://rm.coe.int/168069727c>. Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2010, paragrafi 88, publikuar në vitin 2011. Shih në: <https://rm.coe.int/16806972c7>. Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2015, paragrafi 111, publikuar në vitin 2016. Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>. Raporti i KPT-së për vizitën e fundit në Kosovë në vitin 2020, publikuar në tetor 2021, paragrafët 142, 143, 144, 146. Shih në: https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo-

35. Një nga rekomandimet e MKP-së për UKIP-in ishte edhe furnizimi me dyshekë adekuatë, i cili u zbatua. MKP-ja konsideron se në Repartin e UKIP-it të Klinikës Psikiatrike duhet të bëhen renovime sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që pacientëve t'u sigurohet akomodim në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe nacionale për akomodim të pacientëve të kësaj kategorie. Gjithashtu, edhe KPT-ja, në Raportin për vizitën në Kosovë, i publikuar në tetor të vitit 2021, u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente të ndërmerrnin hapa konkretë për t'i evituar mangësitë e konstatuara për sa u përket kushteve të akomodimit.⁷

Trajtimi dhe aktivitetet në Repartin UKIP

36. Gjatë vizitës (shtator 2022), MKP-ja ka kontrolluar regjistrin e pranimit të rasteve në UKIP dhe nuk ka vërejtur asnjëherë mbipopullim në këtë repart, më së shumti ishin prezentë 10-12 pacientë. Gjatë vizitës së fundit (mars 2023) ishin prezentë katër pacientë, të cilët janë intervistuar dhe ekipi i MKP-së nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për sjellje jo të mirë të personelit. Ankesat e pacientëve kryesisht ishin për kushtet në përgjithësi, e sidomos për dhomat e izolimit, për tualetin e femrave, i cili ishte jashtë funksionit, si dhe për mungesën e aktiviteteve.
37. Gjatë vizitave në këtë repart është vërejtur se trajtimi kryesor është me medikamente dhe se aktivitetet psiko-sociale nuk ishin të mjaftueshme, mungonte ekipi shumëdisiplinor, si: psikologu, punëtori social, terapisti okupacional dhe mungonte plani individual i trajtimit. MKP-ja konsideron se autoritetet dhe institucionet duhet të sigurojnë llojshmërinë e nevojshme të profesionistëve psiko-socialë, si parakusht për një trajtim adekuat të pacientëve.
38. MKP-ja ndër vite ka vërejtur se nuk ka evidenca që është ofruar shpjegim me shkrim për arsyet e trajtimit të pavullnetshëm, ashtu siç parashihet në nenin 21, paragrafi 1.4, të Ligjit për Shëndetin Mendor, i cili shprehimisht përcakton se pacientit të trajtuar pa vullnetin e tij/saj, ndër të tjerash, duhet t'i shpjegohen me shkrim, brenda 48 orëve, arsyet e trajtimit të pavullnetshëm.
39. Për sa i përket së drejtës për trajtim, e njëjta situatë ishte konstatuar edhe nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, në Raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015⁸, 2020⁹, ku theksohej: *“Pranimi i një personi në një institucion psikiatrik mbi baza të pavullnetshme, qoftë në kontekstin e një procesi gjyqësorë civil apo penal, nuk duhet të përjashtojë marrjen e pëlqimit të informuar për trajtim. Çdo shmangie nga ky parim duhet të bazohet në ligj dhe të lidhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse të përshtatshme.”* Në Kosovë në të shumtën e rasteve pacientëve nuk u jepet mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo e drejta për refuzim të trajtimit.

⁷ KPT, Raporti për vizitën në Republikën e Kosovës, publikuar në tetor 2021, paragrafët 124, 125 dhe 127. Shih në: https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo

⁸ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc> (4.7.2018).

⁹ Shih raportin e KPT-së, paragrafi 145, për vizitën e fundit në Kosovë, i publikuar më 23 shtator 2021: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

Mjetet e kufizimit

40. Në UKIP nuk përdoret kufizimi mekanik, por vetëm masa e izolimit dhe kufizimi kimik. Gjatë vizitës, ekipi ka vërejtur se dosjet e pacientëve përmbanin vlerësimin e tre mjekëve neutralë (jo nga mjekët e Repartit UKIP) për vazhdimin e trajtimit të pavullnetsëm, anamnezën, historinë e sëmundjes, formularin për vendosjen në dhoma të izolimit, kërkesën për pranim në spital, por nuk përmbanin pëlqim për trajtim.
41. MKP-ja konsideron se përderisa reparti përdor masën e izolimit, ky mjet kufizimi duhet të jetë subjekt i një politike të detajuar për pacientët të cilët vendosen në dhoma izolimi, e cila duhet t'i përmbajë informatat për situatat kur mund të përdoret izolimi, objektivat e synuara, kohëzgjatjen dhe nevojën për shqyrtim të rregullt të vendimit për izolim, ekzistimin e kontakteve të mirëfillta njerëzore, nevojën që personeli të jetë në mënyrë të veçantë vigjilent.
42. Është vërejtur se reparti nuk ka regjistër të veçantë për personat të cilët vendosen në izolim, prandaj MKP-ja konstaton se ende nuk është zbatuar rekomandimi për të krijuar një regjistër të tillë, i cili iu dërgua autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 26 tetor 2018.¹⁰
43. Edhe KPT-ja, në Raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2020, publikuar në shtator 2021, ka vërejtur se izolimi i pacientëve ishte një praktikë e shpeshtë e kombinuar me administrimin me forcë të ilaçeve. KPT-ja ka theksuar se përdorimi i mjeteve të kufizimit duhet të jetë subjekt i një politike gjithëpërfshirëse dhe ka dërguar një numër rekomandimesh specifike në këtë drejtim.

Kontakti me botën e jashtme

44. Standardet e KPT-së lidhur me trajtimin e pavullnetsëm theksojnë se kontakti i pacientit me botën e jashtme është esencial jo vetëm në kuptim të parandalimit të keqtrajtimit, por edhe nga pikëpamja terapeutike. Pacientët duhet ta kenë mundësinë për dërgimin dhe për pranimin e korrespondencës, të kenë qasje në telefon dhe të pranojnë vizita nga familja dhe nga miqtë e tyre.
45. Pacientët gëzojnë të drejtën për dalje në ajër të pastër dhe për vizitat familjare. Pacientët në repart gjatë ditës i nënshtrohen një rutine ditore, e cila konsiston në aktivitetet, siç janë: ajrosje gjatë gjithë kohës në shëtitore brenda hapësirave të repartit, shikimi i TV-së, ushqimi.

Konstatimet (Përshkrimi i gjendjes në Klinikën Psikiatrike nga MKP-ja)

46. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKP) i Avokatit të Popullit konstaton se mungesa e shtretërve në Psikiatrinë për Fëmijë dhe Adoleshentë dhe hospitalizimi i fëmijëve deri në 18 vjeç në repartet e të rriturve paraqet shkelje dhe cenim të të drejtave të fëmijëve si dhe mosrespektim të standardeve vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve (shih paragrafët 1 dhe 2 të raportit).

¹⁰ Po aty <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-klinikene-psikiatrike-ne-qkuk/>.

47. Lidhur me Repartin e Sëmundjeve të Varësisë (RSV) (shih paragrafin 3 të raportit), MKP-ja konstaton se mungesa e kushteve për rehabilitim afatgjatë të personave të varur nga substancat narkotike, alkooli dhe barnat e përshkruara, po ashtu edhe mungesa e kapaciteteve infrastrukturore, e personelit mjekësor dhe mbështetës, përbën shkelje të të drejtave themelore për kujdes adekuat shëndetësor, njëherësh të garantuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
48. MKP-ja e Avokatit të Popullit konstaton se mungesa e punëtorit social në Klinikën Psikiatrike, prej rreth 7 vjetësh, paraqet vështirësi në ofrimin e trajtimit dhe të rehabilitimit psiko-social të pacientëve (shih paragrafët 4 dhe 20).
49. MKP-ja e Avokatit të Popullit konstaton se mungesa e trajnimeve për personelin e sigurimit, lidhur me natyrën e punës në institucione psikiatrike, paraqet vështirësi kur ftohen nga personeli për t'i ndihmuar në raste të incidenteve në Klinikën Psikiatrike (shih paragrafin 5).
50. MKP-ja e Avokatit të Popullit konstaton se mosaktivizimi i dhomave të veçanta në repartet psikiatrike të spitaleve të tjera regjionale paraqet vështirësi për Repartin UKIP të Klinikës Psikiatrike në Prishtinë, për trajtimin e rasteve urgjente, të cilat sillen nga e tërë Kosova (shih paragrafin 6).
51. Avokati i Popullit përmes gjetjeve të MKP-së konstaton se ndalimi i pacientëve për trajtim të pavullnetshëm pa u njoftuar gjykata kompetente dhe vonesat në marrjen e vendimeve nga gjykata paraqet shkelje dhe cenim të të drejtave të pacientëve. Kjo vjen si rezultat i mospërputhjes mes dispozitave ligjore të përfshira në Ligjin nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore (nenet 75 deri në 96) dhe dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor (nenet 20 deri 24).
52. MKP-ja e Avokatit të Popullit konstaton se kushtet jo të mira të pacientëve në Repartin UKIP, si dhe në dhomat e izolimit, nuk ndihmojnë në kurimin dhe mirëqenien e pacientëve (shih paragrafët 16, 17).
53. MKP-ja e Avokatit të Popullit konstaton se mungesa e dukshme e aktiviteteve psiko-sociale për pacientët në Repartin UKIP dhe në përgjithësi në repartet e Klinikës Psikiatrike, si dhe mungesa e Planit Individual të Trajtimit, nuk ndikon pozitivisht në rehabilitimin e strukturuar të pacientëve.
54. MKP-ja e Avokatit të Popullit konstaton se masa e izolimit, si mjet kufizimi dhe praktikë e shpeshtë në UKIP, si dhe mungesa e protokolleve të veçanta për këtë masë, nuk është në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor dhe me rekomandimet e KPT për vizitën në Kosovë.
55. Lidhur me të gjeturat nga vizita e realizuar në Klinikën e Psikiatrisë, Avokati i Popullit organizoi tryezë diskutimi me institucionet relevante, më 31 maj 2023, ku të pranishmit u pajtuan me të gjeturat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, si dhe në drejtim të përmirësimit të situatës së trajtimit të personave me probleme mendore u dhanë disa rekomandime, të cilat pasuruan raportin e Avokatit të Popullit.
56. Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019

për Avokatin e Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë dhe ShSKUK-së:

1. Të rriten kapacitetet dhe të shtohen shtretërit në Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adoleshentëve.
2. Të krijohet institut ose qendër e veçantë për trajtimin e sëmundjeve të varësisë, ku mund të trajtohet dhe rehabilitohet kjo kategori e pacientëve.
3. Të veprohet dhe të ndërmerren masa urgjente që të angazhohen punëtorë socialë në Klinikën e Psikiatrisë.
4. Të organizohen trajnime për personelin e sigurisë, me qëllim të aftësisë dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale në trajtimin dhe kujdesin për personat që trajtohen në Klinikë.
5. Repartet psikiatrike në spitalet e tjera regjionale duhet t'i aktivizojnë dhomat e veçanta për trajtimin e rasteve urgjente (rekomandim i ripërsëritur).
6. Të nxirren dhe të miratohen edhe aktet nënligjore, në mënyrë që Ligji për Shëndetin Mendor të jetë i zbatueshëm.
7. Të rregullohen kushtet në Repartin UKIP, të mënjanohet lagështia në repart, të funksionalizohet banja e femrave, si dhe dhomat e izolimit të rregullohen dhe të kenë ventilim (shih paragrafët 16, 17).
8. Të krijohen Planet Individuale të Trajtimin për pacientët e hospitalizuar në Klinikën Psikiatrike, ku në ato plane të ceket edhe pëlqimi i pacientit për trajtim dhe hospitalizim, si dhe t'u kushtohet rëndësi aktiviteteve psiko-sociale.
9. Të krijohet protokoll specifik për përdorimin e mjeteve të kufizimit për institucionet psikiatrike, siç kërkohet sipas nenit 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor.

Ministrisë së Drejtësisë

10. Të ndërmarrë masa konkrete për ndryshim-plotësim të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, Kapitullit 3 (Vendosja dhe mbajtja e të sëmurit psikik në institucionin shëndetësor), dispozitave nga neni 75 deri në nenin 96, duke i harmonizuar me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor (nenet 20 deri në 24), lidhur me procedurat dhe afatet dhe të krijojë një kuadër të qartë ligjor lidhur me procedurat dhe afatet e mbajtjes në trajtimin e pavullnetshëm të rasteve civile.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe

masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Populli

